



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.8, datë 24.03.2022

PËR

MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR ME BOT ME NR. 220/1 PROT., DATË 21.03.2017 MIRATUAR ME VENDIM NR.9 DATË 16.02.2017 NGA KBU SEMAN”, DHËNË NË FAVOR TË SUBJEKTIT “ALBAN KALLUCI”

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar me bot, me nr.220/1prot., datë 21.03.2017 miratuar me vendim nr.9 datë 16.02.2017 nga KBU Seman”, dhënë në favor të subjektit “Alban Kalluci”, me vendndodhje Rruga Bargullas Bashkia Poliçan Qarku Berat.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH)

- X=510623,965; Y= 4497561,618; Z=738m.m.n.d.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 0.8 - 1.2 \text{ l/s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

